

BOTA SOT

SOT NË BRUKSEL, SHEFI I UNMIK-ut, PETERSEN, TAKOHET ME HAVIER SOLANËN

KOSOVA - TEMË E VEÇANTË E KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BE-së



Shefi i UNMIK-ut, Soren Jesen Petersen do të marrë pjesë në takimin e ministrave të shteteve të Bashkimit Evropian, që mbahet sot (e hënë, 21 shkurt) në Bruksel. Sipas burimeve tona, Këshilli i Ministrave i Bashkimit Evropian vëmendje të veçantë do t'i kushtojë situatës në Kosovë, kurse kryeadministratori Petersen do t'i prezantojë qëndrimet e tij për gjendjen në Kosovë. **FAQE/2**

VETON SURROI NUK ËSHTË SHENJTOR

Bota Sot si gazetë e qendrës së djathtë për hir të interesave afatgjata të Kosovës e ka pranuar si kryeministër Bajram Rexhepin; Bota Sot e ka pranuar si kryeministër të Kosovës Ramush Haradinajn, dhe do ta pranonte si kryeministër të Kosovës edhe Veton Surroi, nëse ai do të hynte në aleancë qeverisëse me LDK-në. Por Bota Sot nuk i ka pranuar përpjekjet e Surroit që të formonte aleancë qeverisëse me PDK-në, pasi kjo zgjidhje binte ndesh me verdiktin e shumicës së popullit të Kosovës. **FAQE/3**

AFISHE ANTISHQIPTARE NË PODGORICË



FAQE/6

INTERVISTË E EMA BONINOS, DEPUTETE NË PARLAMENTIN EVROPIAN DHE ANËTARE E BORDIT DREJTUES TË GRUPIT NDËRKOMBËTAR TË KRIZAVE

ËSHTË KOHA QË BASHKËSIA NDËRKOMBËTARE TANI TË PRANOJË PAVARËSINË E KOSOVËS



Eurodeputetja dhe anëtarja e Bordit të ICG-së thotë se zvarritja e zgjidhjes së statusit përfundimtar tashmë është tepruar dhe çdo zvarritje rrezikon paqen. Bashkësia ndërkombëtare nuk mund t'i legjitimojë fantazitë e Beogradit dhe Beogradi nuk ka të drejtë vetoje për statusin e Kosovës. Lidhur me procesin integruar evropian të Shqipërisë, eurodeputetja thotë se kjo qeveri ka punuar keq.

FAQE/5

KOMISIONERI EVROPIAN PËR ZGJERIM, OLLI REHN

BALLKANI PERËNDIMOR, DERI MË 2009, NË BE



“Qëllimi im është që deri në vitin 2009, në BE të jenë rreth 27 shtete, bashkë me vendet e Ballkanit Perëndimor...”, tha komisioneri i Bashkimit Evropian për Zgjerim, Olli Rehn. **FAQE/7**

TEMA E SË HËNËS

FAQE/4

KOSOVA ËSHTË NJËRA NDËR PESË KRYEFJALËT E PRESIDENTIT BUSH NË EVROPË

FUNDOSJA E ANIJËS LA TË PAKTËN 59 NJERËZ TË VDEKUR



FAQE/14